



Falënderimet dhe lavdërimet janë vetëm për Allahun. Paqja, mëshira dhe bekimet janë për Muhamedin, për familjen e tij dhe për shokët e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Çështje themelore dhe esenciale për çdo besimtar është që ai të dijë se Allahu i Lartësuar e përsosi dhe e kompletoi fenë islame, tjetër fe e drejtë përveç Islamit nuk është e vërtetë dhe është e refuzuar. Allahu i Lartësuar në disa raste këtë e konfirmon dhe së bashku me një vëmendje të veçantë le t'i lexojmë dhe t'i kuptojmë fjalët e Tij:

????????? ?????????? ?????? ?????????? ?????????????? ?????????????? ?????????????
????????????? ?????? ?????????????? ??????

“Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjedha që Islami të jetë feja juaj.”(Maide, 3)

????? ?????????? ?????? ?????????? ?????????????? ?????? ?????????????? ?????????????? ?????????????
????????????????? ?????????????? ?????????????? ?????????????? ?????????????? ?????????????? ?????????????
????????????? ?????????????? ?????????????? ?????????????? ?????????????? ??????????????

“Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami. Ata që u është dhënë Libri, patën mospajtime nga zilia që kishin midis tyre, vetëm pasi u erdhi dituria. Por kushdo që i mohon udhëzimet e Allahut, ta dijë se Allahu është i shpejtë në llogari.”(Aliimran, 19)

????? ?????????? ?????????? ?????????????????? ?????????? ?????????? ?????????????? ?????????? ?????????? ???
????????????????? ?????? ?????????????????????

“Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur.”(Aliimran, 85)

Këto argumente dhe fakte të tjera nga fjalët e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij janë mjaft të

qarta për një të mençur besimtar për të kuptuar një herë e përgjithmonë se muslimani duhet të jetë besnik ndaj parimeve dhe vlerave të pastra hyjnore. Muslimani i vërtetë, që e njeh fenë e vet, duhet t'i dijë rregullat e respektit dhe të dashurisë, se kujt duhet t'ia dhurojë ato.

Të nderuar muslimanë!

Dashuria, kënaqësia, miqësia ndaj mosbesimtarëve dhe festimi i festave të tyre është në kundërshtim me mësimet islame. Allahu i Lartësuar thotë:

???????????? ?????????? ?????????? ??? ?????????????? ????????????? ??????????????????
???????????????? ?????????????? ?????????????? ??????? ?????? ?????????????????? ??????????
????????????? ?????????? ?????? ?????????? ??? ?????????? ?????????????? ??????????????????

“O besimtarë! Mos i bëni miq e mbrojtës hebrenjtë dhe të krishterët! Ata janë mbrojtës të njëri-tjetrit. Kushdo prej jush që i bën ata miq, është me ata. Vërtet, Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë keqbërësit.”(Maide, 51)

Përvetësimi i traditave të huaja festive qoftë edhe formalisht mbjell afërsi në zemrat e njerëzve.

Pasimin e dëshirojnë të tjerët, por se sa do të jenë të kënaqur, këtë e vërteton Allahu i Lartësuar:

?????? ?????????? ?????? ?????????????? ?????? ?????????????????? ?????????? ??????????????
????????????????? ?????? ??????? ??????? ?????????? ?????? ?????????????? ?????????????? ??????????????
??
????????????? ??????? ??????????

“As hebrenjtë, as të krishterët nuk do të jenë të kënaqur me ty, derisa të pranosh besimin e tyre. Thuaju: “Vetëm udhërrëfimi i Allahut është i drejtë!” E, në qoftë se pas diturisë që të ka zbritur, ti ndjek dëshirën e atyre, atëherë askush nuk do të të ndihmonte apo mbronje nga dënimi i Allahut.”(Bekare, 120)

Pasimi i të krishterëve nga muslimanët, sidomos në festat e tyre, reflekton gëzimin dhe kënaqësinë; me këtë lartësohen bindjet fetare me prejardhje pagane. Muslimani është i obliguar t'i refuzojë dhe të mos i festojë festat e tyre. Respekti dhe nderi ndaj të krishterëve dhe çifutëve shprehet edhe në disa mënyra të tjera, si: përngjasimi në veshje dhe fjalë, lakmia pas moralit të tyre, etj.. Kur muslimani fillon të marrë pjesë në kremtet fetare të krishtera, ai vlerëson lart kulturën shpirtërore joislame. Imitimi i kulturës së huaj është ndjenjë e ulët e disa muslimanëve, prandaj pasimi i mosbesimtarëve nuk është i pranuar, pa marrë parasysh se a ka të bëjë me gjëra të vogla apo të mëdha.

Të nderuar besimtarë!

Muslimanët kanë një program tjetër jetësor, ku nuk lejohet pasimi dhe përngjasimi me jobesimtarët. Allahu i Lartësuar thotë:

????????? ?????????????? ?????????? ?????????????? ??????????????????

